



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr.

Prot.

Tiranë / /2025

Nr. Dok. 202501588/11

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave për kompensimin e ditëve të munguara, të pakryera, nga pushimet e detyrueshme për mësuesit për vitin 2023-2024 për punëmarrësit që mbulohen nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë, Lushnjë.

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER

Lagjja "Kastriot", Rr "Leon Rei"

FIER

**ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR VLORE-HIMARË,
LUSHNJË**

Lagjja "28 Nëntori", Rruga "Siko Nako"

VLORE

Për dëni:

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT

TIRANË

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit, në ushtrim të kompetencave kushtetuese ligjore, në mbrojtje të të drejtave, lirive themelore të shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe interesave të tyre të ligjshme, ka marrë në shqyrtim ankesën e shtetasit z. S.R., në cilësinë e kryetarit të Sindikatës së Pavarur të Arsimit Vlorë (SPA Vlorë), në të cilën

parashtron shqetësimin lidhur me mosrespektimin e kontratës kolektive nga ana e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë, Lushnjë (ZVAP Vlorë-Himarë).

Sipas ankuesit, që në muajin maj të vitit 2024, të gjithë anëtarët e SPA Vlorë kanë ngritur shqetësimin lidhur me afatin e njoftimit për fillimin e lejes vjetore, si dhe përlllogaritjen e saktë të ditëve të lejes vjetore për mësuesit. Më konkretisht, pretendohet mosrespektim i kontratës kolektive (neni 8 i saj) nga ZVAP Vlorë-Himarë, të lidhur midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës dhe Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë, të datës 09.06.2023.

Në vijim të kërkesës së paraqitur në institucionin e Avokatit të Popullit, ankuesi ka dërguar edhe shkresën “Ankesë”, nr. 1/05 prot., datë 31.05.2024, drejtuar Drejtoreshës së ZVAP Vlorë-Himarë, në të cilën pretendohet se: *“... asnjë nga sindikalistët e Institucionave Arsimore të ZVA Vlorë-Himarë nuk është njoftuar për datën e fillimit të pushimeve verore...për të siguruar 56 ditë pune pushim për anëtarët e sindikatës, bazuar në kontratën kolektive, neni 8, pika 3, duhet që mësuesit sindikalistë të fillojnë pushimet verore në datën 18 qershor 2024, që të mund të rikthehen në punë në datën 26 gusht, domethënë 10 ditë para fillimit të vitit të ri shkollor 2024-2025. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se mësuesit sindikalistë kanë për të konsumuar përgjatë verës 49 ditë pune nga totali i ditëve të pushimit vjetor”,* por nuk ka patur asnjë përgjigje.

Pas regjistrimit të kësaj ankese, institucioni i Avokatit të Popullit, ka konstatuar se ankesa plotëson të gjithë kushtet thelbësore si në aspektin formal ashtu edhe në atë substancial për t’u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në nenet 13, 17 shkronja “a” dhe 18, shkronja “b”, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ka vendosur ta pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes.

Në zbatim të detyrimit kushtetues e ligjor, e konkretisht nenit 63, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: *“Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”,* si dhe nenit 19 shkronja “b”, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”,* në vijim të hetimit administrativ me qëllim sqarimin e fakteve e të rrethanave, me shkresën nr. K3/S30 – 2 prot., datë 01.10.2024 “Kërkesë për shpjegime dhe dokumentacion” i kemi kërkuar Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier (DRAP Fier) dhe ZVAP Vlorë-Himarë, dërgimin e informacionit lidhur me:

- *A qëndron pretendimi i ankuesit lidhur me moszbatimin e detyrimeve të kontratës kolektive nga ana e ZVA Vlorë për njoftimin e fillimit të lejes vjetore, për periudhën e verës?*
- *Cila është arsyeja e mospërbushjes së detyrimit kontraktual nga ana e ZVAP Vlorë-Himarë?*

Në përgjigje të shkresës së mësipërme, DRAP Fier me shkresën nr. 1014/1 prot., datë 18.10.2024, na informon se: “...Bazuar në ligjin 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, Urdhri nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, ligjin 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Kontratën Kolektive nr. 3641/1 prot., datë 09.06.2023, neni 8, pika 3, ju bëjmë me dije se: Përcaktimi i kohës së pushimeve vjetore të pagueshme, mbështetet në pikën 2, të nenit 92 dhe në pikën 8, të nenit 181 të Kodit të Punës. Bazuar në këto nene pushimet vjetore për mësimdhënësit dhe drejtuesit e institucioneve arsimore përbëhet nga 56 ditë pune, ku përveç pushimeve verore përfshihen edhe ditët kur mësimi ndërpritet sipas programit mësimor vjetor. Për periudhën e verës koha e pushimit nuk mund të jetë më pak se 45 ditë kalendarike dhe nuk mund të ndërpritet më shumë se një herë. Për vitin mësimor 2023-2024 nga 56 ditë pune të pushimeve vjetore janë ezauruar 12 ditë pune përkatësisht në periudhën dhjetor 2023, janar 2024 dhe prill 2024. Me mbylljen e procesit mësimor dhe të maturës mësuesit fillojnë pushimet verore...Njoftimi i fillimit të lejes vjetore i bëhet me dije nga drejtuesi i institucionit çdo punonjësi arsimor, duke vënë në dijeni paraprakisht edhe ZVAP Vlorë-Himarë.”

Duke qenë se përgjigja e dhënë nuk rezultonte të ishte e plotë dhe shteruese, iu ridrejtua DRAP-së Fier dhe ZVAP-së Vlorë-Himarë, me shkresën nr. K3/S30 – 5 prot., datë 15.11.2024, duke kërkuar sërish informacionin se përse ZVA Vlorë nuk zbaton detyrimet e kontratës kolektive për njoftimin 30 ditë para për fillimin e lejes vjetore për periudhën e verës.

Në përgjigje tonës, me shkresën nr. 2657/1 prot., datë 27.11.2024 ZVAP Vlorë-Himarë na informon se: “...Njoftimi i lejes vjetore i bëhet me dije nga drejtuesi i institucionit çdo punonjësi arsimor, duke vënë në dijeni paraprakisht edhe ZVAP Vlorë-Himarë. Sqarojmë se ZVAP Vlorë-Himarë ka informuar çdo drejtues të IAP-së për datën e fillimit dhe të përfundimit të lejes vjetore, leja e cila fillon në datë 01.07.2024 dhe përfundon në datë 26.08.2024.”

Ndërsa, DRAP-së Fier me shkresën nr. 1014/3 prot., datë 04.12.2024, na informon si vijon: “...është punëdhënësi ai që përcakton dhe miraton kërkesën për leje të çdo punonjësi, datën e fillimit të pushimeve vjetore për mësuesit me të cilët kanë lidhur një kontratë pune. Njoftimi i fillimit të lejes vjetore i bëhet me dije nga drejtuesi i institucionit çdo punonjësi arsimor, duke vënë në dijeni paraprakisht edhe ZVAP Vlorë-Himarë.”

Në kuadër të hetimit administrativ të mësipërm, referuar përgjigjeve të marra nga institucionet tuaja, iu drejtua ankuesit për vënien në dijeni të hetimit dhe qëndrimin që ai mbante. Ky i fundit konfirmon faktin se qëndron përgjigja e DRAP Fier dhënë institucionit tonë, me shkresën nr. 1014/1 prot., datë 18.10.2024. Kjo e fundit është e njëjtë me shkresën nr. 617/1 prot., datë 27.06.2024 me të cilën DRAP Fier i ka kthyer përgjigje Aleancës Sindikaliste SPASH & FSASH Vlorë. Me konkretisht, sipas kësaj shkrese rezulton informacioni si vijon: “...Kujtojmë se nga 56 ditë pune të pushimeve verore janë ezauruar 12 ditë pune, përkatësisht në periudhën dhjetor 2023, janar 2024 dhe prill 2024. Për sa më sipër, **leja vjetore fillon nga data 01.07.2024 deri më datë 31.08.2024.**” Ankuesi gjithashtu është shprehur se, nuk qëndron përgjigja dhe qëndrimi i ZVAP Vlorë-Himarë drejtuar institucionit tonë me shkresën nr.

2657/1 prot., datë 27.11.2024, pasi ZVAP Vlorë-Himarë me shkresën nr. 1036 prot., datë 07.06.2024 i ka kthyer përgjigje Aleancës Sindikaliste SPASH & FSASH Vlorë se: “...Për sa më sipër, theksojmë se koha e pushimit që mësuesit përfitojnë nuk mund të jetë më pak se 45 ditë kalendarike.”.

Në vijim të hetimit administrativ të zhvilluar, i jemi ridrejtuar sërish DRAP Fier dhe ZVAP Vlorë-Himarë, me shkresën nr. K3/S30 – 8 prot., datë 26.02.2025, duke ritheksuar qëndrimin për zbatimin e kushteve kontraktuale të bazuara në ligj, me pyetjet si vijon:

- ...A qëndron pretendimi se, ngjarja është zhvilluar sipas Urdhrit të ZVAP Vlorë-Himarë që i ka drejtuar drejtorëve të Institucioneve Arsimore duke i marrë mësuesit në punë në datë 26 gusht 2024, duke i shkurtuar kështu atyre një javë nga pushimet e tyre verore?

- Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë është shprehur se leja fillon në datën 01.07.2024 dhe përfundon në datë 26.08.2024 (shkresa bashkëlidhur)

- Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier është shprehur se: “Kujtojmë se nga 56 ditë pune të pushimeve vjetore janë ezauruar 12 ditë pune, përkatësisht në periudhën dhjetor 2023, janar 2024 dhe prill 2024. Për sa më sipër leja vjetore fillon nga data 01.07.2024 deri me datë 31.08.2024 (shkresa bashkëlidhur).”

Në përgjigje tonës, ZVAP Vlorë-Himarë me shkresën nr. 898/1 prot., datë 10.03.2025 dhe DRAP Fier, me shkresën nr. 251/2 prot., datë 11.03.2025, të cilat përmbajnë të njëjtin tekst, shprehen se: “...sqarojmë se nuk ka një Urdhër nga ZVAP Vlorë-Himarë drejtuar IA-ve për kthim në punë të mësuesve në datë 26.08.2024. Rithekojmë se nga 56 ditë pune të pushimeve vjetore janë ezauruar 12 ditë, konkretisht në periudhat dhjetor 2023 – janar 2024 dhe prill 2024.”

Referuar gjithë situatës së mësipërme, ankuesi ka pretenduar se:

- 1) Ditët e pushimeve të Vitit të Ri, nuk janë konsumuar në fakt 10 ditë pune, sikurse pretendohet nga autoritetet, por vetëm 7 ditë pune; (konkretisht, sipas ankuesit janë konsumuar 4 ditë pune në dhjetor 2023, përkatësisht datat 26, 27, 28, 29 dhe 3 ditë pune në janar 2025, përkatësisht datat 3, 4, 5).
- 2) Rrjedhimisht, sipas ankuesit, edhe data e fillimit të pushimeve duhet të spostohej me 3 ditë përpara pra, pushimet verore duhet të fillonin në datën 20 qershor 2024 dhe të mbaronin në datën 29 gusht 2024.

Sa sipër, provohet se:

- a) Sipas shkresës nr. 2657/1 prot., datë 27.11.2024 të ZVAP Vlorë-Himarë, njoftimi i lejes vjetore është bërë me datë fillimi 01.07.2024 dhe datë përfundimi 26.08.2024. Ndërkohë, që në shkresat tuaja në vazhdim ky fakt mohohet. Ky qëndrim i institucioneve tuaja, në përgjigjet e dhëna nuk mund të konsiderohet korrekt, për vetë faktin se përgjigjet përveçse nuk argumentohen apo të sqarohen në një formë më të zgjeruar, por edhe janë kontradiktore me atë çfarë ka shprehur vetë ZVAP Vlorë-Himarë, e cila me shkresën e datës 27.11.2024 na ka informuar se: “ ...Njoftimi i lejes

vjetore i bëhet me dije nga drejtuesi i institucionit çdo punonjësi arsimor, duke vënë në dijeni paraprakisht edhe ZVAP Vlorë-Himarë. Sqarojmë se ZVAP Vlorë-Himarë ka informuar çdo drejtues të IAP-së për datën e fillimit dhe të përfundimit të lejes vjetore, leja e cila fillon në datë 01.07.2024 dhe përfundon në datë 26.08.2024”. (në këtë hark kohor numërohen vetëm 40 ditë pune)

- b) Referuar përgjigjes së DRAP Fier dhënë institucionit tonë me shkresën nr. 1014/1 prot., datë 18.10.2024 e cila është e njëjtë me shkresën nr. 617/1 prot., datë 27.06.2024 ku DRAP Fier i ka kthyer përgjigje Aleancës Sindikaliste SPASH & FSASH Vlorë. Me konkretisht, sipas kësaj shkrese rezulton informacioni si vijon: “...Kujtojmë se nga 56 ditë pune të pushimeve verore janë ezauruar 12 ditë pune, përkatësisht në periudhën dhjetor 2023, janar 2024 dhe prill 2024. Për sa më sipër, leja vjetore fillon nga data 01.07.2024 deri më datë 31.08.2024”.
- c) Fillimi i vitit të ri shkollor 2024 – 2025 nuk mund të ishte më vonë se data 29.08.2024 ose thënë me saktë, të paktën 10 ditë para datës 09.09.2024

Më konkretisht, sipas pikës 2, të nenit 64¹ të Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e Rregullores për Funksonimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë” parashikohet:

“...Këshilli i mësuesve e zhvillon mbledhjen e parë të paktën 10 (dhjetë) ditë-pune para fillimit të vitit shkollor”²,

Në Urdhrin e Përbashkët nr. 193, datë 30.04.2024 “Për miratimin e Strukturës së vitit shkollor 2024-2025 në sistemin arsimor parauniversitar”³ të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, parashikohet:

“...Struktura e vitit shkollor 2024-2025 të jetë si më poshtë: 1) Në arsimin bazë: a) mësimet fillojnë më 9 shtator 2024 dhe mbarojnë më 13 qershor 2025;... 2) Në arsimin e mesëm të lartë: a) mësimet fillojnë më 9 shtator 2024 dhe mbarojnë më 13 qershor 2025;...3) Në arsimin profesional: a) mësimet fillojnë më 9 shtator 2024.”

- d) Nuk është e qartë në shkresat tuaja dita e përfundimit të lejes vjetore, çka ngre dyshime për mënyrën e duhur të llogaritjes së saj.
- e) Ankuesit ngrenë pretendimin se janë kthyer në punë në datën 26.08.2024, duke i penalizuar në konsumimin e tre ditëve të tjera leje vjetore. Në fakt nga hetimi

¹ <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Udher-Nr.-31-date-28.01.2020-Rregullore-per-IAP.pdf> dhe <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2024/06/urdher-nr-300-dt-19.06.2024.pdf>

² Në nenin 35 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në republikën e shqipërisë”, parashikohet: “Këshilli i mësuesve të institucionit arsimor, i cili ka në përbërje të gjithë mësuesit dhe kryesohet nga drejtori, është organ kolegjal këshillimor për drejtimin e veprimtarisë së institucionit”.

³ <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2024/06/Urdher-i-perbashket-nr.193-date-30.04.2024-Miratim-i-strukture-se-vitit-shkollor.pdf>

administrativ konstatohet se nga 56 ditë pune leje vjetore në bazë të kodit të Punës dhe kontratës kolektive, nuk është e qartë nëse mësuesit kanë përfitur plotësisht këtë leje vjetore për vitin shkollor 2023-2024.

Më konkretisht, sipas Nenit 92 të Kodit të Punës parashikohet: *1. Kohëzgjatja e pushimeve vjetore të paguara përcaktohen me kontratën kolektive ose me kontratën individuale të punës. 2. Kohëzgjatja e pushimeve vjetore është jo më pak se 22 ditë pune gjatë vitit të punës në vazhdim. Pushimet vjetore nuk përfshijnë ditët e festave zyrtare. Nëse festa zyrtare bie ditën e pushimit vjetor me pagesë, pushimi vjetor shtyhet. 3. Kur punëmarrësi nuk ka kryer një vit pune të plotë, kohëzgjatja e pushimeve vjetore të paguara përcaktohet në raport me kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës. Periudhat e paaftësisë së përkohshme në punë, konsiderohen si kohë pune.*

Në pikën 3 të nenit 8 të kontratës kolektive nr. 3641/1 prot., datë 09.06.2023, të punës parashikohet se: *Përcaktimi i kohës së pushimeve vjetore të pagueshme, mbështetet në pikën 2, të nenit 92 dhe në pikën 8, të nenit 181 të Kodit të Punës. Bazuar në këto nene pushimet vjetore për mësimmshënësit dhe drejtuesit e institucioneve arsimore përbëhet nga 56 ditë pune, ku përveç pushimeve verore përfshihen edhe ditët kur mësimi ndërpritet sipas programit mësimor vjetor.*

–Për periudhën e verës koha e pushimit nuk mund të jetë më pak se 45 ditë kalendarike dhe nuk mund të ndërpritet më shumë se një herë.

Ndërsa koha e programuar plotëson kushtin minimal 45 ditë kalendarike, nuk paraqitet qartë sa ditë janë në total. Në këtë paqartësi mund të ndikojnë edhe diferenca midis vitit kalendarik dhe atij shkollor që kanë kohë të ndryshme fillimi. Gjithashtu edhe komunikimet tuaja në referencë të ditëve të marra përfshinin pushimet e muajit dhjetor 2023.

Duke pasur parasysh dinamikën e këtij rasti gjatë hetimit nga ana jonë, vlerësojmë se, do të kishte qenë formë më e mirë bashkëpunimi institucional nëse do të ishte shpjeguar nga institucionet tuaja mënyra e përlllogaritjes së ditëve për institucionet arsimore parauniversitare. Kjo për të rritur edhe besueshmërinë e punëmarrësve të cilët edhe pse kanë lidhur kontratë individuale, ata sërish kanë nevojë të tutelohen dhe t'i respektohen të drejtat në marrëdhënien punëdhënës dhe punëmarrës.

Është e rëndësishme të kuptohet qartë se bazuar në legjislacionin në fuqi të RSH - së, që vepron në sistemin arsimor parauniversitar, askush prej strukturave drejtuese arsimore, nuk ka të drejtë ligjore të cenojë kohëzgjatjen e pushimeve verore të punonjësve arsimorë.

Po ashtu, theksojmë se, mënyra e trajtimit të kësaj çështjeje nxjerr në pah edhe premisa për cenimin e së drejtës themelore për punën si dhe Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm për nr. 8⁴, të punës së denjë.

⁴ Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm nr. 8 ka si synim Punën dinjitoze dhe rritjen ekonomike, ku më konkretisht në synohet 8.3 *Nxitja e politikave të orientuara nga zhvillimi, që mbështesin veprimtaritë produktive, krijimin e punës së denjë.*

Gjithashtu, përkufizimi i “Punë e denjë” është koncept i dhënë nga ILO⁵, me të kuptohet punësim që respekton të drejtat themelore në punë. Elementët e punës së denjë janë: krijimi i vendeve të punës; të drejtat në punë; mbrojtja sociale; dialogu social.

Në vitin 2023, Shqipëria miratoi Programin aktual kombëtar të Punës së Denjë 2023-2026⁶. Ky është programi i gjashtë i punës së denjë, i nënshkruar dhe zbatuar në bashkëpunim me qeverinë shqiptare dhe partnerët socialë të ILO-s në Shqipëri. Prioritetet e këtij programi janë: mbrojtje efektive në punë; punësim gjithëpërfshirës dhe produktiv; dialog social i përmirësuar.

Ky konstatim bazohet në përcaktimin dhe në detyrimin e organeve të pushtetit publik për të respektuar këto të drejta duke përmbushur korrektësisht procedurat ligjore në frymën dhe kuptimin e ligjit.

Për sa më sipër, në mbështetje të paragrafit 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në përputhje me nenin 18, të ligjit nr. 8510/1999, ku parashikohet respektivisht se: *“Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit..., paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, si dhe “Procedurat për kërkimin dhe përmbushjen e dëmshpërblimit bëhen në përputhje me kërkesat e ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,*

REKOMANDOJMË:

- Gjetjen e mekanizmave për kompensimin e ditëve të munguara, të pakryera, nga pushimet e detyrueshme për mësuesit për vitin 2023-2024.
- Marrjen e masave për mospërsëritjen e të të njëjtave veprime penalizuese pa të drejtë në të ardhmen për të gjithë punëmarrësit e Institucioneve Arsimore Parauniversitare nën juridiksion të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë.
- Marrjen e masave për respektimin e të drejtave të punëmarrësve nga institucionet përgjegjëse, punëdhënësit dhe moskeqpërdorim të pozitës drejtuese.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

<https://albania.un.org/sq/sdgs/8>

⁵ <http://www.ilo.org/public/english/standards/relm/ilc/ilc87/rep-i.htm>

⁶ https://www.ilo.org/sites/default/files/wcmsp5/groups/public/%40europe/%40ro-geneva/%40sro-budapest/documents/publication/wcms_893182.pdf

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj,

K O M I S I O N E R E

Erinda MELI